



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 51, Datë 03.03.2025

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “DELIU 3D” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHIROKU”, ME KAPACITET  
TË INSTALUAR 1,6 MW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38 pika 1, gërma “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.03.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 186/9 prot., datë 28.02.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “DELIU 3D” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k. ka paraqitur kërkesë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shiroku”, me kapacitet të instaluar 1,6 MW, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 30, datë 03.02.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 04.02.2025 dhe 05.02.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 17.02.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 186/4 prot., datë 03.02.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, duke i kërkuar gjithashtu që të bëjë me dije ERE-n në rast se nga ana e MIE-s ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratave të depozituara në kuadër të këtij aplikimi dhe të drejtën e shoqërisë “MER

ENERGJI” sh.p.k. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimit gjenerues përkatës. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Me shkresën nr. 2410/4 prot., datë 05.12.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar që të depozitohet në ERE informacionin/dokumentacionin e aplikimit të konstatuar të munguar ose të depozituar jo në formatin e duhur.
- Shoqëria me shkresën nr. 186/5 prot., datë 12.02.2025 ka depozituar në ERE informacion/dokumentacion plotësues të aplikimit, pas shqyrtimit të të cilit ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 186/6 prot., datë 19.02.2025.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 186/7 prot., datë 21.02.2025 dhe nr. 186/8 prot., datë 25.02.2025, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të ndryshuar, rezulton se:

#### **Paisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:**

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE Kontratën nr. 1894 rep., nr. 1092/3 kol., më 29.08.2018, për ndërtimin dhe operimin e HEC Shiroku me kapacitet 1.600 MW në Bashkinë Gramsh.
- Ka marrë miratimin për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes nga OSSH sh.a., me shkresën nr. 13114/3 prot., më 15.01.2025.
- Ka depozituar në ERE lejen për përdorimin e burimit ujor, miratuar nga KBU Seman me vendimin nr. 17, datë 08.05.2023 (vlefshmëri 5 vjet).
- Ka marrë Vendim për VNM Paraprake nga AKM, më 07.06.2024, dhe ka dokumentuar fillimin e punimeve për ndërtimin e hidrocentralit brenda afatit të vlefshmërisë së kësaj VNM-je referuar kjo:
  - Shkresë e saj nr. 18/6 prot., datë 18.06.2024, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëpërmjet së cilës ajo njofton AKM-në se në datën 01.07.2024 do të fillojnë punimet për ndërtimin e HEC “Shirokut”.
  - Shkresë e saj nr. extra prot., datë 10.12.2024, me anë të së cilës i dërgon AKM-së raportimin për zbatueshmërinë e kushteve të VNM-së Paraprake.
  - Po ashtu, shoqëria ka depozituar edhe Procesverbalin e Inspektimit nr. AKM-BR-2024-00316-2, datë 18.12.2024 dhe vendimin përfundimtar të inspektimit nr. AKM-BR-2024-000316-5, Datë 18.12.2024, të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Berat, ku nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve konstatohet se subjekti vijon ndërtimin e hidrocentralit, të cilin nuk e ka përfunduar ende, dhe se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore.

### **Gjithashtu shoqëria ka depozituar në ERE:**

- Lejen e ndërtimit nr. 1809/3 prot., datë 13.06.2024, për objektin “Ndërtimi i HEC Shiroku, në përroin e Hotomizës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan” sipas vendimit nr. 20, datë 01.03.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit
- Shkresën e saj nr. 18/6 prot., datë 18.06.2024, drejtuar Bashkisë Gramsh, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me anë të së cilës njoftohet këto institucione se punimet për ndërtimin e HEC “Shiroku” do të fillojnë më 01.07.2024
- Shkresën e saj nr. 7/10 prot., datë 07.10.2024, drejtuar MIE-s, me lëndë “Raportim nr. 1 i punimeve në ndërtimin e HEC Shiroku, 3-mujori i tretë i vitit 2024”, nëpërmjet së cilës ajo ka paraqitur raportimin periodik në MIE në kuadër të ecurisë së projektit.
- Shkresën e saj nr. 01/2025 prot., datë 10.01.2025, me lëndë: “Raportimi nr. 2 i punimeve në ndërtimin e HEC Shiroku, 3-mujori Tetor – Dhjetor i vitit 2024”, drejtuar MIE-s, nëpërmjet së cilës ajo ka paraqitur raportimin periodik në MIE në kuadër të ecurisë së projektit.

### **Kushtet dhe Afatet Ligjore:**

- Kontrata nr. 1894 rep., nr. 1092/3 kol., më 29.08.2018, për ndërtimin dhe operimin e HEC Shiroku me kapacitet 1.600 MW, në nenin 4 parashikon një kohëzgjatje prej 49 vjet nga hyrja në fuqi, me të drejtë ripërsëritjeje.
- Bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, afati i vlefshmërisë së licencave për veprimtaritë e prodhimit, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet.
- Shoqëria duhet të vendosë në operim hidrocentralin brenda datës 30.06.2025 referuar kjo përcaktimeve të kontratës nga ku rezulton se shoqëria duhet të vendosë në punë hidrocentralin brenda 30 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, (duke iu referuar datës së zbardhjes së lejes së ndërtimit më 13.06.2024) dhe gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin që në shtojcën 2 të aplikimit në ERE shoqëria ka deklaruar dhe ka parashikuar se operimi i centralit do të jetë brenda qershorit të vitit 2025:
  - Jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të operimit shoqëria, duhet të dorëzojë në ERE dokumentacionin për testimin e veprës.
  - Leja për përdorimin e burimit ujqor është e vlefshme deri më 11.05.2028, ndaj shoqëria duhet të dorëzojë në ERE lejen e rinovuar brenda kësaj date.
  - Nëse leja e përdorimit të burimit ujqor nuk rinovohet brenda datës 11.05.2028, dhe ka një vendim për ndërprerje/pezullim nga autoritetet përkatëse, shoqëria nuk ka të drejtë të operojë.
- Në përfundim, shoqëria “DELIU 3D” sh.p.k. plotëson kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe kushtet e përcaktuara sipas këtij vendimi dhe licencës respektive.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “DELIU 3D” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shiroku”, me kapacitet të instaluar 1,6 MW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.06.2025.
3. Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.
4. Shoqëria duhet të depozitohet në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda datës 11.05.2028.
5. Nëse shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi si dhe nëse ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrijë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit të pikave 2, 3, 4 dhe 5.
7. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “DELIU 3D” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**